



**Organization for Security and Co-operation in Europe  
DEPARTMENT OF HUMAN RIGHTS & RULE OF LAW**

**Përdorimi i gjuhëve të pakicave në komunat e Kosovës**

*dhjetor 2006*



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIMIN E LIGJIT**

**Përdorimi i gjuhëve të pakicave në komunat e Kosovës**

**HYRJE**

Për shkak të bartjes së shtuar të kompetencave në Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (IPVQ) e shoqëruar me tërheqjen graduale të bashkësisë ndërkombëtare, është esenciale të analizohet gjendja ekzistuese nëpër komuna, që ka të bëjë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore të pakicave.

Qëllimi i këtij raporti është të jepet një pasqyrë e qartë e përdorimit të gjuhëve të pakicave në Kosovë, për të vlerësuar nëse standardet gjuhësore janë përmbushur në nivelin komunal dhe cilat masa duhet të ndërmerren nga autoritetet komunale për të siguruar përmbushjen e plotë të të drejtave gjuhësore të personave që u takojnë komuniteteve të pakicave.

Raporti fokusohet në përmbledhjen e realizimit të Kreut 4 ‘Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre’ në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Korniza Kushtetuese), dhe të legjisllacionit tjetër të nivelit qendror dhe komunal.<sup>1</sup> MË tutje, ky raport ofron një pasqyrë mbi mundësinë e komuniteteve të pakicave për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, për të ushtruar të drejtën e tyre për komunikim në gjuhën e tyre me të gjitha organet komunale dhe a gëzojnë shërbyesit civilë trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e jetës së tyre. Ky raport do të shërbejë gjithashtu si mjet për identifikimin e mangësive në përmbushjen e të drejtave gjuhësore dhe për ngritjen e çështjeve kyçe për vëmendjen e autoriteteve qendrore dhe lokale, me qëllim të sigurimit të realizimit të këtyre të drejtave.

Me qëllim të sigurimit të të drejtave të barabarta dhe pa diskriminim dhe mundësi të barabarta për komunitetet e pakicave, Administrata e përkohshme e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) në Kosovë, ka shpallur në fuqi Rregulloren nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, me të cilën parashikohet detyra e autoriteteve komunale lidhur me përdorimin e të dy gjuhëve zyrtare (shqipe dhe serbishte) në Kosovë.

---

<sup>1</sup> Ligji në fuqi në Kosovë përfshin Kornizën Kushtetuese Kreun 4 – Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3 – Ligji kundër diskriminimit neni 2 i shpallur në fuqi përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/32; Ligji për realizimin e barazisë së gjuhëve dhe alfabetit në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovë nr. 48/1977; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, neni 9 mbi gjuhët; Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2003/12 për Qasjen në dokumentet zyrtare, i shpallur në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/32; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/43 për Numrat, emrat dhe kufijtë e komunave; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/36 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/43 dhe Urdhëresa administrative nr. 2004/23 për numrin, emrin dhe kufijtë e komunave.

Ashtu siç parashikohet edhe në Kornizën Kushtetuese, IPVQ-të janë të obliguara të respektojnë dhe sigurojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të përcaktuara, midis tjerash edhe me, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kartën Evropiane për Gjuhët Regjionale ose të Pakicave dhe me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.<sup>2</sup>

## **GJETJET**

Ky raport bazohet në vlerësimin e kryer nga “Ekipet komunale” të Misionit të OSBE-së në Kosovë (EK OSBE) nga muaji mars deri në muajin gusht të vitit 2006, me të cilin përfshihen 30<sup>3</sup> komuna të Kosovës, plus tri<sup>4</sup> pilot njësitë komunale ekzistuese.

Sipas gjetjeve të EK të OSBE-së, janë identifikuar disa shqetësime të përbashkëta në komuna të ndryshme.

### ***I. Informatat e përgjithshme mbi përdorimin e gjuhës nëpër komuna***

Njëzetetë komunat e vlerësuara (përfshirë pilot njësitë komunale) i kanë statutet komunale të cilat janë në pajtim me dispozitën e nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë “Statuti i komunës përmban dispozita të hollësishme për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve, ashtu siç parashikohet në këtë nen, duke marr parasysh përbërjen e komuniteteve në komunë”. Mirëpo, vetëm pesë<sup>5</sup> prej këtyre statuteve komunale në mënyrë specifike deklarojnë se janë në përdorim janë më shumë se dy gjuhë zyrtare, ndërsa 23 tjerat nuk e theksojnë në mënyrë të shprehur se janë dy gjuhë zyrtare, dhe kjo kuptohet se në fakt

---

<sup>2</sup> Kreu 3 i Kornizës Kushtetuese – të drejtat e njeriut

3.1 Të gjithë personat në Kosovë gëzojnë, pa diskriminim të asnjë lloji dhe në barazi të plotë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

3.2 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në arenën ndërkombëtare të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë ato të drejta dhe liri të parashtruara në:

(a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut;

(b) Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj;

(c) Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj;

(ç) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;

(d) Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

(dh) Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;

(e) Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe

(ë) Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

3.3 Dispozitat për të drejtat dhe liritë e parashtruara në këto instrumente aplikohen në Kosovë drejtpërsëdrejti si pjesë e kësaj Kornizë Kushtetuese.

<sup>3</sup> Pejë/Peć, Istog/Istok, Deçan/Dečane, Klinë/Klina, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Kaçanik/Kaçanik, Shtime/Štimlje, Viti/Vitina, Gjilan/Gnjilane, Prizren, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Gjakovë/Đakovica, Malishevë/Mališevo, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gillogoc/Glogovac, Obiliq/Obilić, Podujevë/Podujevo, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Zubin Potok, Vushtrri/Vučitran, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zvečan, Skenderaj/Srbica dhe Mitrovicë/Mitrovica.

<sup>4</sup> Junik, Hani i Elezit/Đeneral Janković dhe Mamuša/Mamushë/Mamuša pilot njësitë komunale.

<sup>5</sup> Dragash/Dragaš, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Obiliq/Obilić, Mitrovicë/Mitrovica dhe pilot njësia komunale e Mamushës/Mamuša/Mamuša.

janë dy gjuhë zyrtare në përdorim nga komunat për shkak se referohet në mënyrë të shprehur në dispozitën e nenit 9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45. Pesë statutet tjera<sup>6</sup> i referohen vetëm gjuhës shqipe ndërsa në disa raste anglishtja është zyrtare dhe në rastin e Leposaviqit/Leposavić, propozim statuti komunal nuk është miratuar nga Kuvendi Komunal për shkak të mungesës së konsensusit politik.

Përveç kësaj, asnjë nga komunat e analizuara nuk posedojnë ndonjë dokument plotësues të shkruar ose politikë komunale krahas statutit dhe me të cilën i referohet në ndonjë mënyrë përdorimit të gjuhës ose që do të mund të shërbente si udhëzim me të cilin do të matej veprimi i zyrtarëve komunal nëse është ose nuk është në përputhje me politikën e obligueshme të përdorimit të gjuhës.

Një problem tjetër i vërejtur në shumë prej komunave të vlerësuar është mungesa e daljes në terren ose mungesa e masave specifike nga komuna për të informuar personat që u takojnë komuniteteve të pakicave lidhur me të drejtat e tyre ose për shërbimet komunale në dispozicion. Në shumicën e rasteve, komuna demonstroi një qasje të reagimit ndaj adresimit të kërkesave nga pakicat, shqetësimeve dhe nevojave të tyre, pra vetëm duke përmbushur standardin minimal të mekanizmave të krijuar siç është Zyra komunale e komuniteteve (ZKK), dhe jo ndonjë qasje pro-aktive për të punuar dhe qasur komuniteteve.

Mirëpo, ka pasur disa nisma pozitive komunale. Zyrtarët komunal të Klinës/Klina rregullisht takohen me komunitetet e pakicave duke përfshirë serbët e Kosovës të kthyer nëpër qytete, për të diskutuar shqetësimet e komunitetit. Ferizaji/Uroševac e publikon buletin informativ i cili u shpërndahet komuniteteve të pakicave përmes katër zyrave lokale të komuniteteve. Në Kamenicë/Kamenica botohen fletushka informative lidhur me funksionet e departamenteve të ndryshme në të dyja gjuhët zyrtare. Zyrtarët e Gjakovës/Đakovica i kanë vizituar të zhvendosurit në Mal të Zi dhe në Manastirin e Deçanit/Dečane. Në Podujevë/Podujevo, zyrtarët komunal i vizitojnë rregullisht komunitetet e pakicave. Kryetari i Kuvendit Komunal të Lipjanit/Lipljan tash së voni ke mbajtur takime me udhëheqësit e fshatrave, ka mbajtur debate publike në Lepi/Lepina dhe Gushtericë e Ulët/Donja Gušterica dhe ka marrë pjesë në mbledhjen e fshatit Grackë e Vjetër/Staro Gracko lidhur me vandalizmin ndaj varrezave të serbëve të Kosovës. Në Prishtinë/Priština, Departamenti për arsim dhe krye-shëf i ekzekutiv (KE) kanë punuar bashkërisht me ZKK për identifikimin e pjesëtarëve potencial të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për të shërbyer si mësues. Në Komunën e Rahovecit/Orahovac është duke u zhvilluar me sukses fushata gjashtëmujore e integritetit të serbëve të Kosovës përmes aktiviteteve të daljes në teren dhe të aktiviteteve tjera të ndërtimit të besimit.

Sa i përket nismave komunale për ngritjen e vetëdijes ose për organizimin e trajnimeve për shërbyesit civilë lidhur me përdorimin e gjuhës, nuk ka pasur thuajse fare ndonjë përpjekje nga komunat për evitimin e mos-respektimit dhe mos-përputhshmërisë me rregullat e përdorimit të gjuhës së pakicave.<sup>7</sup>

<sup>6</sup> Kačanik/Kaçanik, Malishevë/Mališevo, Glogoc/Glogovac dhe pilot njësi komunale e Hanit të Elezit/Đeneral Janković. Plani i Podujevës/Podujevo për revidimin e statutit në shtator 2006.

<sup>7</sup> Ka pasur disa përjashtime në disa komuna. Gjilani/Gnjilane është në proces të organizimit të trajnimeve në bashkëpunim me OSBE-në (mirëpo, trajnimi është ndërprerë për momentin për shkak se propozimi duhet të dorëzohet sërish për miratim). Në Shtime/Štimlje është organizuar diskutim në tryezë të rrumbullakët sa herë që ngritën shenja të reja nëpër fshatra. Në Novobërdë/Novo Brdo

***II Respektimi i përdorimit të gjuhëve nga komuna (qasja e pakicave në informata) – çështjet e përkthimit.***

Në bazë të nenit 9.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45, “Mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij dhe tubimet publike, të gjitha duhet të mbahen në të dy gjuhët: shqip dhe serbisht. Në komunat ku gjuha e komuniteteve nuk është as shqipja as serbishtja, dhe ku ata përbëjnë një pjesë substanciale të popullsisë, aktet dhe procesverbalet gjithashtu duhet të përkthehen në gjuhën e këtyre komuniteteve sa here që paraqitet nevoja” dhe nenit 9.3 “Të gjitha dokumentet zyrtare të komunës shtypen në dy gjuhë: shqip dhe serbisht. Në komunat ku jetojnë bashkësitë kombëtare, gjuha e të cilave nuk është as shqipja e as serbishtja, dhe ku ata përbëjnë një pjesë substanciale të popullsisë, të gjitha dokumentet zyrtare shtypen gjithashtu edhe në gjuhën e këtyre komuniteteve”. Gjithashtu, Kreu 4, neni 4.4 (c) i Kornizës Kushtetuese thekson se komunitetet dhe pjesëtarët e tyre “...gëzojnë qasje në informatë në gjuhën e tyre amtare”. Bazuar në shënimet e mbledhura nga EK të OSBE-së, është e qartë se në këtë drejtim, në tërë Kosovën nuk është arritur përshtatshmëria gjuhësore në nivelet komunale.

Lidhur me përgjigjen e pranuar nga EK të OSBE-së, 26 komuna pohojnë se i kanë kapacitetet joadekuate për t'i përmbushur obligimet që dalin nga neni 9.2 dhe 9.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45. Nga shpjegimet më të shpeshta që ishin dhënë, përfshihej mungesa e mjeteve financiare për shkak të kufizimeve buxhetore të Kosovës, që sipas 11<sup>8</sup> komunave rezultojnë me pamundësinë e punësimit ose angazhimit të përkthyesve dhe interpretuesve për ngritjen e kapaciteteve të përkthimit; 11<sup>9</sup> komuna sigurojnë se stafi prezent është i tej-ngarkuar me punë, për shkak të numrit të tyre të vogël, dhe resurseve të mangëta; mungojnë përkthyesit profesional dhe me përvojë dhe kjo kontribuon cilësisë së dobët të dokumenteve të përkthyer në shtatë<sup>10</sup> raste; 16<sup>11</sup> komuna kanë cituar dokumentet e pranuar vetëm në gjuhën shqipe

---

vazhdohet me kurse të gjuhës, sipas kërkesës, për shërbyesit civil. Në Pejë/Peć është formuar komisioni prej pesë personave kontaktues të cilët kanë filluar me raportimin e veçantë mbi çështjet e gjuhës dhe gjithashtu paraqesin rekomandimet e nevojshme për drejtoritë komunale lidhur me adresimin e boshllëqeve në zbatimin e politikës.

<sup>8</sup> Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Gjilan/Gnjilane, Vushtrri/Vučitrn, Skenderaj/Srbica, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Mitrovicë/Mitrovica. Në Novobërdë/Novo Brdo, mungesa e rregullt e përkthyesit ka pasur ndikim negativ në përkthimin e dokumenteve dhe nuk ka pasur përkthim gjatë mbledhjeve. Në vend të ndërmarrjes së masave disiplinore për këtë sjellje mospërfillëse, komuna ka refuzuar të merr masa për angazhimin e përkohshëm të zëvendësimit, duke pohuar se individët e kualifikuar nuk do të punon për pagesë aq të vogël dhe përkundër rritjes së buxhetit, i duhet të reduktojë stafin për nëntë punëtorë tjerë. (Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçan së voni i kanë përkeqësuar lidhjet me institucionet e IPVQ-ve që ka ndikim tjetër negativ për arritjen e standardeve për përdorimin e gjuhës. Kjo gjithashtu tregon për një mungesë të përgjithshme të vullnetit politik sikur për shembull në Zvečan/Zveçan, ku komuna pretendon se nuk është prioritarë përmbushja e kërkesave për përdorimin e gjuhës kur janë mbi 4,000 të zhvendosur në këtë komunë).

<sup>9</sup> Štrpce/Shtërpçë, Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Gjakovë/Đakovica, Obiliq/Obilić, Zvečan/Zveçan, Mitrovicë/Mitrovica, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Klinë/Klina.

<sup>10</sup> Ferizaj/Uroševac, Viti/Vitina, Prizren, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Skenderaj/Srbica.

<sup>11</sup> Štrpce/Shtërpçë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina, Gjilan/Gnjilane, Prizren, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Gjakovë/Đakovica, Malishevë/Mališevo, Vushtrri/Vučitrn, Skenderaj/Srbica dhe Mitrovicë/Mitrovica. Në Novobërdë/Novo Brdo, kryetari i KK këtë çështje e ka ngritë para Ministrisë së Drejtësisë. Pilot njësia

nga autoritetet qendrore gjë që e përkeqëson situatën edhe më tej. Vetëm Komuna e Malishevës/Mališevo haptazi e ka kundërshtuar nevojën për përmbushjen e kërkesave gjuhësore.

Përkitazi me pajisjet dhe punën e përkthimit, gjendja duke të jetë e përzier në mbarë Kosovën. Janë ende shtatë<sup>12</sup> komuna ku njësitë e përkthimeve ende nuk janë themeluar. Janë edhe gjashtë<sup>13</sup> raste ku përkthyesit e komunës ende nuk janë punësuar. Rrjedhimisht, komunitetet e pakicave në veri të Ibrit plotësisht janë të varura nga UNMIK-ut për sigurimin e shërbimeve të përkthimit. Në Istog/Istok, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština, Skenderaj/Srbica, Mitrovicë/Mitrovica dhe Prizren ku kapacitetet e përkthimit ose janë të kufizuara ose tepër të ngarkuara, UNMIK-u ofron ndihmë plotësuese të përkthimit, ose gojor ose me shkrim, për përkthyesit e komunave. Përkthyesi i Shtimes/Štimlje mund të konsiderohet jozyrtar për shkak se ai mbanë një pozitë tjetër në komunë si zyrtar i informimit publik.

Në përgjithësi, shumë prej këtyre komunave ose e kanë përmirësuar ose gradualisht janë duke e përmirësuar qasjen e komuniteteve të pakicave në informata. Gjithashtu, në komunat e Prishtinës/Priština, Obiliqit/Obilić dhe Pejës/Peć janë publikuar konkurset për përkthyes por shumë pak kandidatë të kualifikuar janë paraqitur ndërsa në Malishevë/Mališevo, e cila deri më tani ka qenë hezituese deri më tani për zbatimin e politikës për përdorimin e gjuhës, së fundi e ka caktuar një shërbyes civil nga drejtoria e administratës së përgjithshme si përkthyesin e parë komunal (Prishtina/Priština së fundi e ka plotësuar njërin nga dy vendet e lira të punës, Obiliqi/Obilić e ka punësuar përkthyesin e dytë me kontratë mujore me mundësi zgjatje deri në hapjen e postit të përhershëm, ndërsa Peja/Peć e ka hapur konkursin (tash së voni) për kandidatin me diplomë të albanologjisë duke e kufizuar mundësinë për konkurruesit nga pakicat. Pas dorëheqjeve të përkthyesve të mëparshëm në vitin 2005, Gjakova/Đakovica së fundi i ka punësuar dy përkthyes me orar të plotë. Katër<sup>14</sup> komuna i kanë dërguar kërkesat drejtpërdrejtë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) për mjete shtesë për fuqizimin e kapaciteteve përkthyes duke punësuar përkthyes tjerë. Me përjashtimin e Malishevës/Mališevo dhe Glogocit/Glogovac, të gjitha komunat tjera ose i përkthejnë të gjitha dokumentet e komunës ose së paku një pjesë të vogël syresh.<sup>15</sup> Një konstatim i përbashkët është se në 11<sup>16</sup> komuna shpesh ka

---

komunale e Mamushës/Mamuša/Mamuša i merr dokumentet vetëm në gjuhën shqipe dhe serbisht nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe Administratës (MPLA) edhe pse 95 % e popullatës janë turq të Kosovës dhe një nga gjuhët zyrtare në këtë pilot njësi komunale është gjuha turke.

<sup>12</sup> Novobërdë/Novo Brdo, Kaçanik/Kaçanik, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo, Glogoc/Glogovac, Obiliq/Obilić dhe pilot njësi komunale e Hanit të Elezit/Đeneral Janković.

<sup>13</sup> Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zvečan. Glogoci/Glogovac momentalisht është në proces të rekrutimit të dikujt. Në pilot njësitë komunale të Mamushës/Mamuša/Mamuša dhe Hanit të Elezit/Đeneral Jankovic, nuk është paraparë nga MPLA punësimi i përkthyesve.

<sup>14</sup> Klinë/Klina, Kaçanik/Kaçanik dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Zubin Potoku ka marrë përgjigje negative ndaj kësaj kërkesë.

<sup>15</sup> Në Deçan/Dečane ka pasur disa angazhime për përmirësimin e numrit të dokumenteve të përkthyer por këto janë kufizuara. Në Kaçanik/Kaçanik disa vendime komunale, rregulla të procedurës dhe statuti i komunës janë përkthyer. Në Shtime/Štimlje 90% e dokumenteve janë të përkthyer. Në Prizren edhe pse dokumentet janë të përkthyer, cilësia e përkthimit në gjuhën serbe është mjaft e dobët. Suharekë/Suva Reka gradualisht është duke përmirësuar për deri më sot janë përkthyer vetëm pak dokumente. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje përkthimi i dokumenteve është i ndikuar për shkak të mungesës së përkthyesve ose konflikteve lidhur me afatin, prandaj nuk janë përkthyer të gjitha. Në Lipjan/Lipljan shumica e dokumenteve janë përkthyer. Në Gjakovë/Đakovica është shfaqur logoja e re mbi të gjitha dokumentet zyrtare dhe e përkthyer në tri gjuhët. Të gjitha përkthimet janë ndërprerë në

vonesa në përkthimin e dokumenteve të cilat mund t'i atribuohen ose ngarkesës së stafit me punë ose vonesave në shpërndarjen e dokumenteve tek përkthyesit. Është me rëndësi se vetëm gjysma e komunave të vlerësuara bashkërisht pretendojnë se i përdorin të gjitha gjuhët zyrtare në komunikimin zyrtar, informimin publik dhe dokumentacionin e komunës.

Në përgjithësi, përkthimi simultan gjatë mbledhjeve komunale është i mundur në mbarë Kosovën.<sup>17</sup> Mirëpo, në Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Novobërdë/Novo Brdo sigurohet vetëm përkthimi konsektiv. Tani pajisjet për përkthim simultan janë në të gjitha komunat përveç nëntë<sup>18</sup> prej tyre, edhe pse rrallë herë të përdorura, ose nuk janë vënë në funksion ose presin të instalohen.

Duhet të përmendet se deri më sot, vetëm Komuna e Gjilanit/Gnjilane është në proces të organizimit të trajnimeve gjuhësore për ngritjen e kapaciteteve tek shërbyesit civil, gjersa, Novobërda/Novo Brdo ka mbajtur orë të gjuhës për shërbyesit civil prej dhjetorit të vitit 2005 deri në janar 2006. Gjithashtu, sipas ZKK-së në Viti/Vitina, kërkesat për kurse gjuhësore janë refuzuar nga drejtori i administratës së përgjithshme.

Gjithashtu, bazuar në dëshmitë e mbledhura nga EK të OSBE-së, 17<sup>19</sup> komuna shpallin informatat e ndryshme prej vendeve të lira të punës dhe tenderëve deri të vendimet komunale dhe rregulloreve, në tabelën e shpalljeve ose në dy dhe në rastin e Prizrenit dhe Dragashit/Dragaš, në tri gjuhët. Mirëpo, në Shtime/Štimlje dhe Prishtinë/Priština nuk azhurnohen rregullisht informatat e shpallura. Përveç dhjetë<sup>20</sup>

---

Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçan për shkak të ndërprerjes së lidhjeve me IPVQ-të.

<sup>16</sup> Istog/Istok, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë, Vushtri/Vučitrn, Skenderaj/Srbica, Mitrovicë/Mitrovica, Rahovec/Orahovac dhe Gjakovë/Đakovica. Në Pejë/Peć, Komiteti për politikë dhe financa nuk i merr dokumentet e përkthyer. Në Prishtinë/Priština nganjëherë mbledhjet shtyhen për shkak të vonesave në përkthim. Në Gjilan/Gnjilane ftesat dhe materialet tjera shpesh vonohen ose nuk janë të përkthyer fare për drejtorin serb të drejtorisë së bujqësisë.

<sup>17</sup> Vushtri/Vučitrn, Istog/Istok, Pejë/Peć dhe Lipjan/Lipljan, janë tani duke filluar t'i japin këto shërbime. Në Prizren nuk është siguruar përkthimi në turqisht gjatë diskutimit publik për pjesën e dytë të planit rregullativ urbanistik, e as në gjuhën boshnjake gjatë ngjarjes së organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me prezantimin e planit të veprimit për kuvendet e të rinjve të Kosovës. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, përkthimi nuk është bërë kohëve të fundit në komitetin për politika dhe financa, gjersa në Skenderaj/Srbica dhe Podujevë/Podujevo, përkthimi simultan sigurohet nëse ka pjesëmarrje të pakicave në mbledhje ose kur kjo kërkohet nga komuna për shkak se në këto komuna nuk ka ose ka fare pak komunitet të pakicave. Në Dragash/Dragaš dhe Rahovec/Orahovac shërbimet e përkthimit simultan janë në dispozicion dhe shfrytëzohen rregullisht. Më herët, kjo është zbatuar edhe në Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçan, mirëpo, që nga shkëputja e raporteve me IPVQ-të rrallëherë mbahen mbledhjet komunale të detyrueshme.

<sup>18</sup> Malishevë/Mališevo, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan, Glogoc/Glogovac, Deçan/Dečane dhe Kaçanik/Kaçanik. Në pilot njësinë komunale të Mamushë/Mamuša/Mamuša, nuk parashihet nga MPLA donacioni i pajisjeve. Në Mitrovicë/Mitrovica disa pjesë të pajisjeve ende mungojnë. Në pilot njësinë komunale të Hanit të Elezit/Đeneral Janković niveli qendror i ka thënë kësaj njësie se ata do t'i marrin pajisjet për përkthim më vonë si një hap përpara i decentralizimit.

<sup>19</sup> Istog/Istok, Pejë/Peć, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë, Viti/Vitina, Gjilan/Gnjilane, Prizren, Dragash/Dragaš, Kamenicë/Kamenica, Rahovec/Orahovac, Gjakovë/Đakovica, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan, Prishtinë/Priština dhe Vushtri/Vučitrn. Në Ferizaj/Uroševac vendet e lira të punës shpallen vetëm në shqip. Në pilot njësinë komunale të Mamushës/Mamuša/Mamuša për mbledhjet publike.

<sup>20</sup> Kaçanik/Kaçanik, Suharekë/Suva Reka, Malishevë/Mališevo, Glogoc/Glogovac, Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan, Skenderaj/Srbica, Lipjan/Lipljan dhe Klinë/Klina.

komunave të cilat i shpallin informatat vetëm në gjuhën shqipe ose vetëm në serbishte, komunat tjera ose nuk i kanë tabelat fare të ngritura sikurse është rasti në Mitrovicë/Mitrovica dhe në pilot njësinë komunale të Junikut, ose tabela e shpalljeve rrallëherë përdoret sikur në Obiliq/Obilić dhe Deçan/Dečane.

Krahas kësaj, tetë<sup>21</sup> komuna i kanë hapur në mënyrë vullnetare faqet e internetit në të dyja gjuhët dhe në rastin e Prizrenit në katër gjuhë me qëllim të sigurimi të qasjes së barabartë në informata për të gjitha komunitetet e pakicave. Shtatë komuna tjera<sup>22</sup> ose i kanë faqet e internetit në zhvillim e sipër ose janë në proces të azhurnimit të faqeve të tyre të internetit për të siguruar se i përmbushin obligimet gjuhësore në të dyja gjuhët zyrtare. Vetëm në rastin e Malishevës/Mališevo ka pasur rezistencë të prerë komunale për sigurimin e informatave në gjuhën serbe. Përkundër këtyre zhvillimeve ekziston nevoja e përgjithshme për sforcimin e përdorimit të të gjitha gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve tjera të pakicave në çdo aspekt të jetës komunale për të siguruar se pakicat i shfrytëzojnë plotësisht të drejtat e tyre.

### ***III. Pajtueshmëria komunale me përdorimin e gjuhëve – pajtueshmëria me shenjat***

Në bazë të nenit 9.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, “shenjat zyrtare që bëjnë me dije apo përfshijnë emrat e qyteteve, qytezave, udhëve, rrugëve dhe vendeve tjera publike do t’i jep ato emra në gjuhën shqipe dhe serbe. Në komunat në të cilat jeton një komunitet gjuha e të cilit nuk është as gjuha shqipe as serbe, këto emra do të jepen në gjuhën e atij komuniteti”. Shënimet e përpiluara dukshëm demonstrojnë këtë në këtë drejtim, respektimi në nivel komunal i rregullores nuk është zbatuar në mënyrë efektive në tërë Kosovën.

Bazuar në informatat e mbledhura nga EK të OSBE-së, 13<sup>23</sup> të komunave të vlerësuara nuk shfrytëzojnë emrat e vendeve të caktuara zyrtare të parashikuara me

---

<sup>21</sup> Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Prizren, Dragash/Dragaš, Gjakovë/Đakovica dhe Podujevë/Podujevo. Në Viti/Vitina personi i caktuar për përkthimin e faqes nuk e flet serbishten dhe varet nga përkthyesi zyrtar i komunës për sigurimin e materialit në kohë (mangësitë lidhur me cilësinë e pamjaftueshme profesionale dhe numrit të vogël të përkthyesve). Në Vushtrri/Vučitrn vetëm 13 deri në 14 rregullore komunale janë përkthyer.

<sup>22</sup> Obiliq/Obilić, Shtime/Štimlje, Prishtinë/Priština dhe Mitrovicë/Mitrovica. Podujeva/Podujevo planifikon të kompletojë të gjitha punët deri në vjeshtën e vitit 2006. Gjilani/Gnjilane së voni ka përparuar dukshëm dhe Suhareka/Suva Reka është duke e përkthyer ngadalë internetin në serbisht.

<sup>23</sup> Malishevë/Mališevo. Në Istog/Istok fshati Gjurakovac/Đurakovac referohet si Gurrakoc. Në Viti/Vitina statuti nuk i përmbahet rregullores. Rahoveci/Orahovac i referohet tre fshatrave me emra të ndryshëm (Gurikuq për Petkoviq/Petković, Malesi e Vogël për Radostë/Radoste dhe Fortese në vend të Bellacërkë/Bela Crkva). Në Suharekë/Suva Reka shpeshherë komuna referohet si Therandë mirëpo tani komuna është duke filluar që të distancohet nga përdorimi i këtij emri në disa nga dokumentet e veta zyrtare dhe faqja e internetit e komunës shfaq emrin e duhur të komunës. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje tre fshatrat i referohen vetëm një gjuhe zyrtare në dokumentet dhe komunikimet zyrtare. Në Glllogoc/Glogovac komuna referohet si Drenas në dokumentet zyrtare, shenjat e rrugës dhe në botimin e tretë të buletinit të komunës. Në Obiliq/Obilić disa shenja të fshatrave nuk shfaqin emrin e duhur në gjuhën serbe përderisa shenja e rrugës kryesore ndërmjet Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Priština shfaq emrin jozyrtar Kastriot. Krahas kësaj KKK dhe kryeministri gjatë një vizite që i bënë komunës i'u referuan me gojë emrit të komunës si Kastriot. Në Prishtinë/Priština në disa dokumente zyrtare, rregullore dhe vendime emrat joekzistues të fshatrave përdoren si Bardhosh/Devet Jugoviča në vend të emrit zyrtar Nëntë Jugoviqët/Devet Jugoviča. Në Vushtrri/Vučitrn ndonjëherë dokumentet zyrtare të dorëzuara nga drejtorët komunal përfshijnë emrat jozyrtar të vendeve. Në Zubin Potok,



Rregulloren e UNMIK-ut 2000/43 dhe 2004/36 dhe Udhëzimin Administrativ 2004/23 në të gjitha komunikimet zyrtare.<sup>24</sup>

Në përgjithësi, shumë nga komunat e vlerësuara kanë përmirësuar ose përpjekur që të përmirësojnë gradualisht të gjitha format e pajtueshmërisë komunale me shenjat. Në Prizren, për shembull, emrat e rrugëve përmenden në gjuhën shqipe, serbe apo turke varësisht nga zona e lokalitetit dhe titulli i emrit të rrugës. Megjithatë, vazhdojnë të ekzistojnë rastet e ndryshme të mos-pajtueshmërisë, mungesa e nismës apo veprimi të organeve komunale për të implementuar masat korrigjuese. Gjithashtu ekziston një praktikë e vazhdueshme nga organet në përdorimin e vetëm gjuhës së shumicës në rrugë, lokalitet, rrugë dhe shenjat e lokaleve komunale. Në Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçan shenjat janë ekskluzivisht të shfaqura në gjuhën serbe. Në fshatrat me shumicë serbe të Kosovës në Prishtinë/Priština, Lipjan/Lipljan, Pejë/Peć dhe Istog/Istok, shenjat janë vetëm në gjuhën serbe, përderisa në Glogoc/Glogovac, Malishevë/Mališevo dhe Kaçanik/Kaçanik, shumë shenja shfaqen vetëm në gjuhën shqipe.

Dëshmitë tregojnë se shumë komuna shfaqin probleme të zakonshme të ndërlidhura me zbatimin e pajtueshmërisë me shenjat: në shtatë<sup>25</sup> komunat, shenjat janë bërë të palexueshme; në dhjetë<sup>26</sup> komuna vetëm fjala ‘rrugë’ është e përkthyer në shenjat e rrugëve përndryshe emrat mbeten në gjuhën e shumicës<sup>27</sup>; dhe disa lokale komunale dhe fshatra në 18<sup>28</sup> komuna madje nuk shfaq shenjat e caktuara apo edhe nëse janë të

---

Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçan vetëm emrat në gjuhën serbe referohen në të gjitha komunikimet zyrtare.

<sup>24</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/43 për numrin, emrat dhe kufijtë e komunave; Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/36 për ndryshimin e Rregullores Nr. 2000/43 për numrin, emrat dhe kufijtë e komunave dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 2004/23 për numrin, emrat dhe kufijtë e komunave. Është me rëndësi të ceket se UA 2004/23 përmban disa gabime sa i përket drejtshkrimit në gjuhën serbe të disa vendeve për shkak se nuk bën dallim ndërmjet letrave “c”, “ć” dhe “č”.

<sup>25</sup> Pejë/Peć, Suharekë/Suva Reka dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Në Klinë/Klina ekzistojnë raste të rralla. Shenjat në shkollën në Rahovec/Orahovac dhe objektin shëndetësor në fshatin Ratkocë/Ratkovac janë bërë ta palexueshme. Në Prishtinë/Priština shenjat në gjuhën shqipe janë fshirë në shkolla, shtëpi të shëndetit dhe gjykata në fshatrat me shumicë serbe si dhe shenjat në gjuhën serbe janë fshirë në zonat me shumicë shqiptare. Në Skenderaj/Srbica shenjat e rrugëve/fshatrave janë fshirë.

<sup>26</sup> Gjilani/Gnjilane, Suharekë/Suva Reka dhe Gjakovë/Đakovica. Në Klinë/Klina emërtimi i rrugëve mbetet një rrugë pa krye në kuvendin komunal. Në Štrpce/Shtërpçë rrugët nuk kanë emra. Në Ferizaj/Uroševac emrat e rrugëve pritet të miratohen nga kuvendi komunal. Në Rahovec/Orahovac zonat e banuara me serbë të Kosovës shfrytëzojnë mbishkrimet në gjuhën serbe. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje emërtimi i rrugëve ende pritet të bëhet. Skenderaj/Srbica dhe Pilot Njësia Komunale Mamuşa/Mamushë/Mamuša nuk ka shenja të rrugëve.

<sup>27</sup> Duhet të ceket se madje edhe në rastet kur shenjat janë në pajtim me përdorimin e gjuhëve, emri i rrugës shpesh mund të bartë një konotacion të rëndësishëm politik për shkak se çka mund të koniderohet e duhur mundet të mos qëndrojë e njëjtë në aspektin e drejtshkrimit apo mundet të marrë konotacion përçmues për komunitetin i cili përdor gjuhën tjetër.

<sup>28</sup> Suharekë/Suva Reka. Në Pejë/Peć mbishkrimet në shkolla janë vetëm në gjuhën shqipe. Në Istog/Istok mbishkrimet e shkollës në Čerkolez/Črkolež janë vetëm në gjuhën serbe përderisa shtëpia e kulturën nuk ka fare mbishkrim. Në pilot njësinë komunale në Junik mbishkrimet në shkollë dhe shtëpinë e shëndetit janë në gjuhën shqipe. Në Štrpce/Shtërpçë mbishkrimi në ndërtesën e komunës nuk është në gjuhën shqipe. Në Ferizaj/ Uroševac pjesa serbe e shenjës rrugore në hyrje të qytetit është larguar përderisa në hyrjen tjetër të qytetit shenja është e palexueshme. Në Kamenicë/Kamenica disa fshatra nuk kanë shenja (mbishkrime). Në Viti/Vitina shumica e mbishkrimeve (shenjave) në lokalet e komunës janë vetëm në gjuhën shqipe. Në Gjakovë/Đakovica shenjat (mbishkrimet) në shkollë dhe shtëpinë e shëndetit janë vetëm në gjuhën shqipe sikurse edhe shenja në hyrje të qytetit. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje jo të gjitha shenjat (mbishkrimet) në dyert e drejtorateve komunale janë të shfaqura mirëpo ato për momentin janë në proces të finalizimit. Në Vushtrri/Vučitrn disa shenja

shfaqura ato janë vetëm në një gjuhë zyrtare. Në tërësi, 20<sup>29</sup> komuna shfaqin një standard të pajtueshmërisë me shenjat.

Sa i përket përdorimit komunal të drejtshkrimit korrekt në secilën nga gjuhët zyrtare, pajtueshmëria ka tendencë të ndryshojë. Shënimet tregojnë që 17<sup>30</sup> nga komunat e vlerësuara në disa raste nuk iu përmbahen rregulloreve të sipërpërmendura mbi drejtshkrimin zyrtar. Në disa raste, mospërputhjet paraqiten në shenjat rrugore/fshatrave në dokumentet zyrtare përfshirë këtu edhe referimin emrave të vendeve jo-ekzistuese. Në aspektin pozitiv, në Rahovec/Orahovac dhe Skenderaj/Srbica gabimet e kaluara në drejtshkrim janë korrigjuar së paku pjesërisht.

---

(mbishkrime) në fshatra mungojnë apo emrat nuk janë përkthyer. Në Skenderaj/Srbica shenjat (mbishkrimet) në shkollë janë vetëm në gjuhën shqipe. Në Mitrovicë/Mitrovica disa shenja të rrugëve në qytet janë hequr. Në Lipjan/Lipljan gjuha shqipe nuk shfaqet në ndërtesat e shkollave minoritare. Në Rahovec/Orahovac fjala “shkollë” është përkthyer mirëpo emri në gjuhën shqipe është i përdorur dhe e njëjta vlen edhe për shtëpinë e shëndetit. Në Deçan/Deçane shenjat (mbishkrimet) në dyert e drejtorive janë vetëm në gjuhën shqipe. Në Podujevë/Podujevo shenjat (mbishkrimet) në dyer qoftë mungojnë apo në rastin e Drejtoratit për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë është vetëm në gjuhën shqipe. Në Klinë/Klina të gjitha informatat brenda qendrës kryesore të shëndetit janë vetëm në gjuhën shqipe.

<sup>29</sup> Istog/Istok, Klinë/Klina, Novobërdë/Novo Brdo, Štrpce/Shtërpçë, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Shtime/Štimlje, Gjilan/Gnjilane, Pejë/Peć, Dragash/Dragaš, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka, Prishtinë/Priština, Podujevë/Podujevo, Vushtri/Vučitrn dhe Mitrovicë/Mitrovica. Në Prizren çdo gjë është në pajtim me përdorimin e gjuhëve përpos emblems së komunës që është në gjuhën shqipe dhe angleze dhe mbishkrimet (shenjat) e reja për momentin janë duke u vendosur në pjesën e mbetur të lokaleve të komunës siç është ndërtesa ‘Bankos’. Në Obiliq/Obilić të gjitha shenjat (mbishkrimet) janë në pajtim përpos shenjave (mbishkrimeve) të tre fshatrave të cilat janë vjedhur. Në Lipjan/Lipljan komuna kishte alarmuar Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit për një mbishkrim (shenjë) që nuk është në pajtim me përdorimin e gjuhëve e cila është larguar mirëpo nuk është zëvendësuar me një tjetër, përderisa Pilot Njësia Komunale Mamuşa/Mamushë/Mamuşa ka vetëm një shenjë (mbishkrim).

<sup>30</sup> Viti/Vitina, Prishtinë/Priština, Zvečan/Zveçan, and Mitrovicë/Mitrovica and Prizren. Në Istog/Istok emri i fshatit Gurrakoc është jo i drejtë. Në Ferizaj/Uroševac ekzistojnë shembuj në përkthime të përdorimit të fjalëve jo-ekzistuese. Në Rahovec/Orahovac ekzistojnë disa përjashtime të vogla përkitazi me shenjat (mbishkrimet). Në Gjakovë/Đakovica ekzistojnë disa gabime në shenjat (mbishkrimet) e fshatit/rrugëve. Në Malishevë/Mališevo ekzistojnë shumë gabime në shenjat (mbishkrimet) e fshatit/rrugëve. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje emrat e fshatrave me shqiptim jokorrekt përdoren në dokumentet dhe bisedat zyrtare (Livragonë/a në vend të Vragoli/Vragolija). Në Obiliq/Obilić ka raportime të shqiptimit të gabuar në gjuhën serbe. Glogoc/Glogovac përdor vetëm shqiptimin në gjuhën shqipe. Në Lipjan/Lipljan ekzistojnë disa gabime në shenjat (mbishkrimet) e rrugëve në gjuhën serbe. Në Vushtri/Vučitrn shenja (mbishkrimi) në rrugë në hyrje të qytetit që bie nën pushtetin e Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit nuk është në pajtim me përdorimin e gjuhëve. Në Leposavić/Leposaviq dhe Zubin Potok drejtshkrimet në përgjithësi janë vetëm në gjuhën serbe.

#### ***IV. – Implementimi i të drejtave gjuhësore të komuniteteve pakicë rome, ashkallike, egjiptase, turke, boshnjake dhe gorane***

Në tërë nënin 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, disa garanci ligjore janë të përcaktuara për të siguruar përdorimin e gjuhëve të komuniteteve gjuha e të cilëve nuk është as gjuha shqipe as ajo serbe dhe i cili komunitet përbën një pjesë substanciale të popullatës. Shënimet e përpiluara tregojnë se në përgjithësi këto komunitete janë në gjendje të komunikojnë në gjuhën e tyre vetjake me institucionet dhe zyrtarët komunal. Megjithatë, përgjigjet komunale në kërkesat e komunitetit që ndërliken me përdorimin e gjuhëve të tyre kanë qenë tejet jo-konsistente.

Pas analizimit të të dhënave ekzistuese, shihet se ekzistojnë disa raste kur komunitetet rome, ashkallike, egjiptase, turke apo boshnjake kanë parashtruar kërkesa të posaçme zyrtarëve gjegjësisht komunal për përdorimin shtesë të gjuhës në çfarëdo forme në gjuhën e tyre amtare.<sup>31</sup> Për më tepër, ekzistojnë vetëm disa raste të raportuara si në Pejë/Peć dhe Prizren ku organet komunale janë angazhuar në një nismë të rritjes apo forcimit të mëturshëm të të drejtave gjuhësore të komuniteteve pakicë. (Në Pejë/Peć, organet nxorën një vendim të kuvendit komunal me të cilin kërkohen që të gjitha informatat të shkruara në gjuhën serbe të jenë në alfabetin latin ashtu që të plotësojnë nevojat e komunitetit boshnjak të Kosovës, përderisa përdorimi i gjuhës turke dhe boshnjake është bërë i zakonshëm nga organet komunale). Është me rëndësi të ceket se e drejta për të komunikuar në gjuhën amtare sigurohet për personat që i takojnë të gjitha komuniteteve anembanë Kosovës përpos në rastin e komunitetit boshnjak në Deçan/Dečane të cilët siç raportohet frikohen të flasin gjuhën boshnjake në publik dhe se këndejmi preferojnë që të flasin në gjuhën shqipe.

Është raportuar se pjesëtarët e komuniteteve rome, ashkallike dhe egjiptase komunikojnë qoftë në gjuhën serbe apo shqipe me organet komunale dhe në rastin e Gjakovës/Đakovica, komuniteti boshnjak artikulon nevojat e veta vetëm në gjuhën shqipe për shkak të nivelit të lartë të integritimit në komunitetin shumicë.<sup>32</sup> Kjo gjendje është identike për komunitetin turk në Vushtrri/Vučitrn, edhe pse zyrtarët komunal deklarojnë se nuk ekziston ndonjë mekanizëm institucional për të garantuar që pjesëtarët e komunitetit kanë qasje në shërbime në gjuhën turke.

#### **PËRFUNDIMET**

---

<sup>31</sup> Në Dragash/Dragaš, komunitetet gorane dhe boshnjake të Kosovës kanë kërkuar që shenjat (mbishkrimet) e reja në fshat të vendosen në vendet ku janë fshirë apo janë bërë të palexueshme apo në rastet kur drejtshkrimi në gjuhën shqipe i paraprin gjuhës serbe/boshnjake (shenjat për momentin janë duke u zëvendësuar për të tretën herë). Komuna është në proces të zëvendësimit të të gjitha shenjave (mbishkrimeve) e sipërpërmendura. Në Gjilan/Gnjilane, komuniteti turk i Kosovës ka dorëzuar kërkesa me shkrim nëpërmjet të Komitetit për Komunitete kryetarit të KK-së duke kërkuar që shenjat (mbishkrime) dhe dokumentet të shfaqen në gjuhën turke. Kërkesa duhet të ngrihet gjatë seancës së kuvendit komunal. Në Mitrovicë/Mitrovica, komuniteti turk i Kosovës ka kërkuar formalisht nga komuna që gjuhës turke t'i jepet një status i barabartë si gjuhë zyrtare dhe duhet të shfaqet në shenjat e rrugëve dhe dokumente. Çështja gjithashtu është ngritur në Qendrën Rajonale të OSBE-së dhe debatuar në kuadër të Komitetit për Komunitete. Sipas komunës, kërkesat për dokumente janë plotësuar me vonesa dhe kuvendi komunal pohon se nuk posedon autoritet për të marrë vendim përfundimtar në këtë çështje.

<sup>32</sup> Edhe pse romët flasin qoftë gjuhën serbe apo shqipe, ka gjasa që ata mundën t'i drejtohen komunës nëpërmjet të ZKK-së në komunat ku romët përbëjnë një pjesë të madhe të popullatës së përgjithshme.

Vlerësimi gjithë-kosovar i zhvilluar mbi pajtueshmërinë e komunave me gjuhët e pakicave demonstroi disa suksese dhe boshllëqe në praktikën ekzistuese implementuese dhe identifikon shumë shqetësime. Përkundër përparimit të shënuar, ende ekziston hapësirë për përmirësimin e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave gjuhësore të pakicave nga organet komunale dhe qendrore. Dështimi për të vepruar në pajtim me kërkesat obligative gjuhësore kanë rezultuar në një qasje të përgjithshme reaguese nga ana e shumë komunave për të adresuar nevojat e komuniteteve pakicë duke përmbytur shkallën minimale të pajtueshmërisë me gjuhët. Implementimi i përgjithshëm i të drejtave gjuhësore të komuniteteve pakicë mbetet i pabarazuar plotësisht në tërë Kosovën dhe si rezultat i kësaj qasjeje të pakicave në informata, pajtueshmëria me shenjat komunale, ndërtimi i kapaciteteve për çështjet gjuhësore dhe arritja komunale tek të gjitha komunitetet pakicë vazhdon të jetë i paarrtur në disa vende.

Shkaktarët e kësaj gjendjeje burojnë nga boshllëqet në legjislacionin ekzistues, dhe dështimi për të përcaktuar pajtueshmërinë me gjuhët si prioritet komunal, mungesa e ndarjes së duhur të burimeve ekzistuese komunale dhe qendrore, neglizhenca e përgjithshme, varshmëria e vazhdueshme në bashkësinë ndërkombëtare – bëjnë që Departamenti i UNMIK-ut për Administratë Civile (DAC) dhe OSBE-ja – të ofrojnë shërbimet për të plotësuar boshllëqet komunale, hezitimin politik apo rezistencën në aplikimin e ligjit. Kjo ka rezultuar në një mosrespektim të të drejtave individuale të pakicave dhe në rastet e caktuara edhe në diskriminim të mundshëm të pakicave. Këto veprime rezultojnë në shkelje të qarta të parimeve të mos-diskriminimit qoftë i drejtpërdrejt apo tërthorë bazuar në gjuhën dhe përkatësinë etnike dhe të mos i përmbahet parimeve të përfaqësimit të drejtë të të gjithë personave dhe tolerancës ndëretnike të popullit të Kosovës siç parashikohet me ligjin e Kuvendit të Kosovës kundër diskriminimit.

Për më tepër, rezultatet e këtij vlerësimi ngrisin shqetësimin përkitazi me përdorimin e gjuhës serbe si një zëvendësim të barabartë të gjuhës boshnjake me qëllim të respektimit të legjislacionit mbi gjuhët në komunat ku gjuhët e komuniteteve nuk janë as ajo shqipe as serbe dhe komuniteti boshnjak përbën një pjesë substanciale të popullatës.

Në kohën kur është përpiluar ky raport, nuk ka ekzistuar ndonjë përkufizim i qartë në kornizën legjislative të Kosovës që elaboron se deri në çfarë mase organet qendrore mund të rregullojnë, ndërhyjnë, anulojnë vendimet e komunës dhe të shqiptojnë veprime disiplinore ndaj komunave veçanërisht përkitazi me çështjet e mos-pajtueshmërisë me legjislacionin. Kjo është adresuar në Ligjin e ri të Kosovës për Përdorimin e Gjuhëve dhe tani duhet të zbatohet në mënyrë efektive<sup>33</sup>.

Mbrojtja efektive e të drejtave të pakicave është e pasqyruar në Planin për Zbatimin e Standardeve të Kosovës dhe Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian. Përkundër këtyre zhvillimeve, OSBE-ja inkurajon të gjitha palët e interesuara që të ndërmarrin masa të menjëhershme për të mbrojtur të drejtat individuale dhe grupore të të gjitha komuniteteve në Kosovë.

---

<sup>33</sup> Ligji i Asamblese Nr. 02/L-37 shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/51 të 20 tetorit 2006.

## **REKOMANDIMET**

### ***1. Për komunat***

**Të pajtohet me kornizën ekzistuese ligjore** përfshirë këtu edhe ligjin kundër diskriminimit, kornizën kushtetuese, ligjin për qasje në dokumentet zyrtare dhe Rregulloret e UNMIK-ut që rregullojnë vetëqeverisjen e komunave dhe numrin, emrat dhe kufijtë e komunave.

**Sigurori implementimin e barabartë të të drejtave gjuhësore të komuniteteve pakicë** për shqiptarët e Kosovës dhe komunitetin serb të Kosovës duke u pajtuar me ligjin e ri të Asamblese së Kosovës për Përdorimin e Gjuhëve.<sup>34</sup>

**Promovoni përdorimin e komitetit të komuniteteve dhe atij për ndërmjetësim** si një nga organet kryesore komunale për secilin individ në Kosovë për të ngritur vetëdijen, promovuar të drejtat individuale dhe pakicave dhe kundërshton qëndrimin komunal për çfarëdo çështje që ndikon në popullatën e përgjithshme.

**Prioritetet e ndarjes së fondeve nga burimet ekzistuese komunale** për të siguruar që ekzistimi i kapaciteteve adekuate të përkthimit dhe interpretimit (p.sh përkthimi me gojë dhe shkrim, të gjitha format e komunikimit zyrtar, pajtueshmëria e shenjave) duke plotësuar të gjitha format e pajtueshmërisë me kërkesat e përkthimit të artikuluar në kornizën përkatëse ligjore. Këto masa korrigjuese do të përmirësojnë aftësinë e të gjitha komuniteteve për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes.

**Sigurori implementimin e plotë të përdorimit të gjuhës boshnjake sipas nevojës** bazuar në përbërjen e popullatës në aspektin e komuniteteve kur gjuha e tyre amtare nuk është as gjuha shqipe as serbe dhe kur këto komunitete përbëjnë një pjesë substanciale të popullatës. Kur faqet e internetit të krijohen, punoni në garantimin që të gjithë individët të kenë qasje të barabartë në këto informata në të gjitha gjuhët zyrtare. Intensifikoni aktivitetet e arritjes tek komunitetet pakicë për të ngritur besimin e komuniteteve në institucionet komunale. Organizoni në mënyrë aktive nismat për ndërtimin e kapaciteteve për stafin komunal përkitazi me rëndësinë e të drejtave gjuhësore individuale. Ndërmerrni nismat për të ngritur vetëdijen e shoqërisë civile për rëndësinë e pajtueshmërisë me ligjin mbi gjuhët si mjet për garantimin e të drejtave individuale dhe grupore.

### ***2. Për Ministrinë e Pushtetit dhe Administratës Lokale***

Përkitazi me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë Shtojca XIV pika (iii) (e) dhe (i):

**Udhëzoni komunat për implementimin e Rregulloreve të UNMIK-ut** për vetëqeverisjen komunale ofroni mbështetje për komunat në ndërmarrjen e nismave të nevojshme për ndërtimin e kapaciteteve përfshirë këtu edhe organizimin e trajnimit të

---

<sup>34</sup> Që nga 21 shtatori 2006, ligji i ri për gjuhët është nxjerrë nga kuvendi i Kosovës mirëpo ende pritet të shpallet nga PSSP-ja.

nevojshëm për stafin komunal që do të garantojë më tutje të drejtat gjuhësore dhe do të sigurojë një përparim të rëndësishëm përkitazi me legjislacionin për gjuhët.

**Rishikoni Udhëzimin Administrativ 2005/7** për implementimin e përgjegjësive të Ministrisë së Pushtetit dhe Administratës Lokale në lidhje me monitorimin dhe mbikëqyrjen e komunave për të adresuar boshllëqet e caktuara në kornizën legjislative të Kosovës siç është sigurimi që komunat veprojnë në pajtim të plotë me nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 dhe përgjegjësitë tjera komunale.

**Përmirësoni kapacitetin e sektorit të themeluar për të monitoruar pajtueshmërinë me gjuhët** në nivel ministror dhe komunal duke ndarë financimin e nevojshëm dhe stafin e nevojshëm për të monitoruar në mënyrë të rregullt dhe efektive pajtueshmërinë në fjalë.

### *3. Për Ministrinë e Transportit dhe Komunikacionit*

**Ndërmerrni të gjitha veprimet korrigjuese** përkitazi me vendosjen dhe zëvendësimin e shenjave të rrugës të palexueshme dhe jo në pajtim me ligjin mbi gjuhët që bijnë në kuadër të kompetencave së ministrisë. Gjithashtu siguroni komunikimin e rregullt me komunat.

### *4. Për Ministrinë e Shërbimeve Publike*

**Përmirësoni kapacitetin e sektorit të themeluar** për të monitoruar pajtueshmërinë me ligjin mbi gjuhët në nivel ministror dhe komunal duke ndarë fondet dhe stafin e nevojshëm për të monitoruar në mënyrë të rregullt dhe efektive pajtueshmërinë me ligjin mbi gjuhët.

### *5. Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha ministrinë tjera*

**Gjithmonë ofroni komunave dokumentacionin në të gjitha gjuhët zyrtare** dhe gjithashtu në gjuhët e komuniteteve gjuha e të cilëve nuk është as gjuha shqipe as serbe mirëpo përbën pjesë substanciale të popullatës së komunës për të siguruar qasjen e barabartë në informata për të gjithë individët.

**Promovoni implementimin e vazhdueshëm të të gjitha standardeve për Kosovën** në nivel qendror dhe komunal dhe gjithmonë ofroni trajnim në nivel qendror për nëpunësit civil komunal në gjuhët e të gjithë pjesëmarrësve.

### *6. Për UNMIK-un*

**Rishikoni shtojcën e Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2004/23** për të siguruar që drejtshkrimi zyrtar i të gjitha vendeve të jetë i siguruar.